

Islami dhe shtyllat e tij

الإسلام وأركانه

< Shqip – Albanian – ألباني >



Abdullah Ahmed El-Huvejl

عبد الله بن أحمد الحويل



Përktheu: Jusuf Kastrati

ترجمة: يوسف كاستراتي

ISLAMI DHE SHTYLLAT E TIJ**Përkufizimi gjuhësor i fjalës *Islam*:**

Fjala *Islam* (الإسلام) gjuhësisht domethënë *nënshtrim, dorëzim dhe përvulje*.

Përkufizimi fetar i fjalës *Islam*:

Islam në terminologjinë fetare domethënë: “*Dorëzim ndaj Allahut me Teuhid, nënshtrim në bindje ndaj Tij dhe largim nga shirku dhe ithtarët e tij*”.

Islami në kuptimin e përgjithshëm dhe në kuptimin e veçantë:

- a. Islami në kuptimin e përgjithshëm domethënë: “Adhurimi ndaj Allahut nëpërmjet asaj që Ai e ka ligjësuar që nga dërgimi i pejgamberëve deri në Kijamet”.
- b. Islami në kuptimin e veçantë është ajo me të cilën ka ardhur Muhamedi ﷺ.

SHTYLLAT E ISLAMIT**Shtyllat e Islamit janë pesë:**

1. Dëshmia se nuk ka të adhuruar me të drejtë përveç Allahut dhe se Muhamedi është i Dërguari i Allahut.
2. Falja e namazit.
3. Dhënia e zekatit (lëmoshës së detyrueshme).
4. Agjërimi i ramazanit.
5. Kryerja e haxhit, për atë që ka mundësi.

Shtyllat e Islamit janë dy llojesh:

- a. Shtylla pa të cilat nuk mund të qëndrojë Islami, ndryshe quhen “shtylla thelbësore”, të cilat janë:
 1. Dëshmia se nuk ka të adhuruar me të drejtë përveç Allahut dhe se Muhamedi është i Dërguari i Allahut.
 2. Falja e namazit.
- b. Shtylla pa të cilat nuk mund të plotësohet Islami, ndryshe quhen “shtylla plotësuese”, të cilat janë:

1. Dhënia e zekatit (lëmoshës së detyrueshme).
2. Agjërimi i ramazanit.
3. Kryerja e haxhit, për atë që ka mundësi.

Argumenti për shtyllat e Islamit:

Thënia e të Dërguarit të Allahut ﷺ: *"Islami është ndërtuar mbi pesë shtylla: Dëshmia se nuk ka të adhuruar me të drejtë përveç Allahut dhe se Muhamedi është i Dërguari i Tij, pastaj falja e namazit, dhënia e zekatit, agjërimi i ramazanit dhe kryerja e haxhit."*
[Muslimi].

